



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.100, datë 25.08.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 39, DATË 01.06.2018, “PËR LICENCIMIN E
SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME KONISPOL”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 25.08.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 39, datë 01.06.2018 "Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Konispol",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Konispol (**UK Konispol**) me shkresën nr. 75 prot. datë 21.07.2020, me lëndë "Dërgim dokumentacioni për ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të sh.a Ujësjiellës Kanalizime Konispol" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Konispol për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.
3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Konispol për herë të parë me vendimin nr. 39, datë 01.06.2018 "Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Konispol", me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria

autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Konispol sh.a. z. Altier Xhaferi, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi në vitin 2009.
5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Konispol sh.a. z. Aurenc Shehu ka mbaruar studimet e larta Master Profesional në Inxhinieri e Burimeve Natyrore në profilin Gjeomatik në vitin 2013.
6. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Konispol sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Konispol është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 39, datë 01.06.2018 “Për licencimin e sh.a Ujësjellës Kanalizime Konispol” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor Altier Xhaferi”

“Drejtues Teknik Aurenc Shehu”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani